



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr.08
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302
Prishtinë, më 6 korrik 2021, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë : Fatmire Kollçaku, Miljana Nikoliq, Haxhi Avdyli, Mirsad Shkreta, Burim Karameta, Bekim Haxhiu, Shemsedin Dreshaj dhe Samra Ilijazi, anëtarë.

Munguan : Armend Zemaj, Labinotë Demi- Murtezi dhe Uran Ismaili, anëtarë.

Stafi mbështetës: Shpresa Haxhijaj, koordinatore dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë i fushës/analist.

Pjesëmarrës të tjerë: Granit Bllaca, KDI, Violeta Salihu, KSH dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Fatmire Kollçaku, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 22.06.2021;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për amendamentimin 02 të Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut, për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim “KSV/017:Programi për mbështetje shëndetësore (pjesa II);
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 22.6.2021

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 22.6.2021, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për amendamentimin 02 të Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut, për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim “KSV/017: Programi për mbështetje shëndetësore (pjesa II)

Fatmire Kollçaku, tha se sa përket shqyrtimit të kësaj pike, duhet të veprojmë sipas Rregullores së Kuvendit, ku në nenin 60, është Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, ku thuhet si në vijim:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, i ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare me ligj, në bazë të nenit 18 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.
2. Projektligji për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare përmban tekstin e marrëveshjes ndërkombëtare, arsyet e ratifikimit dhe deklaratën financiare, në rastet kur ka implikime buxhetore.
3. Procedimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Kollçaku kërkoi që të miratohet ky projektligj, pasi që i plotëson të gjitha kushtet.

Mirsad Shkreta, tha që në parim është pro miratimit, ratifikimit të kësaj marrëveshjeje, por, ne si deputet, duhet ta kemi një njoftim për fazën e parë, së çka ka ndodhur me Programin për mbështetje shëndetësore (pjesa I), pasi që siç dihet pjesa e parë e kësaj marrëveshjeje nuk është zbatuar ashtu siç ka qenë e paraparë për zbatimin e projektit të Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH-it), i cili akoma nuk është përfunduar. Shëndetësia ka shume probleme në vendin tonë, në mungesë të mospërfundimit të SISH-it, nuk ka informacion të saktë së çka ka ndodhur konkretisht me moszbatimin e këtij projekti, ku janë shpenzuar shuma të mëdha të mjeteve financiare dhe nuk është realizuar ky projekt, prandaj për Programin për mbështetje shëndetësore (pjesa II), duhet të sigurohemi se si do të zbatohet.

Shemsedin Dreshaj, theksoi se në parim është pro miratimit të kësaj marrëveshjeje, por përvoja më fazën e parë nuk ka qenë e mirë në zbatim. Pajtohem me kolegun Mirsad Shkreta, që të kemi një informatë për Programin për mbështetje shëndetësore pjesa e parë, sepse nuk kemi informacion të duhur së çka ka ndodhur në realitet, sidomos me pajisjet që kanë qenë të parapara për funksionimin e Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH-it), ndërsa për pjesën e dytë, duhet të jemi syçelë dhe kërkoi që komisioni ta mbikëqyrë zbatimin e këtij programi.

Bekim Haxhiu, tha se kjo marrëveshje nuk krijon kosto shtesë, është një ndihmesë për pajisjet mjekësore. Duhet ta përkrahim, sepse ka investime të drejtpërdrejta në pajisjet mjekësore. Lidhur me Sistemin Informativ Shëndetësor (SISH-in), tha që është një projekt i domosdoshëm për shëndetësinë kosovare. Ndërsa për dështimin e këtij projekti, duhet të kërkohet Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), ta kryej një auditimi të tërësishëm që nga fillimi, se çka ka ndodhur më këtë projekt.

Fatmire Kollçaku, tha se pasi po pajtohemi që miratimi i këtij projektligji me marrëveshje, është në të mirën e shëndetësisë së vendit, atëherë sipas rregullave, po e procedojmë për miratimi në Kuvend, në seancën plenare.

Pas diskutimeve, shumica e deputetëve të Komisionit votuan për dhe Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Projektligji për amendamentimin 02 të Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut, për Projektin e bashkëpunimit për zhvillim “KSV/017:Programi për mbështetje shëndetësore (pjesa II)

4.Të ndryshme

Fatmire Kollçaku, i njoftoi lidhur më tryezën që është planifikuar të mbahet ditën e mërkurë, më 14 .7. 2021, në orën 10:00, me temën “Të drejtat dhe Siguria e pacientit”, ku do të ftohen Shoqata për të Drejtat e Pacientëve, përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, nga një përfaqësues i odave të mjekëve, Ndërsa sa i përket mirëqenies sociale, tha se do të dakordohemi për mbledhjet e radhës, t’a ftojme, ministrin e Financave, Punës dhe Transefereve, z. Hekuran Muratin.

Bekim Haxhiu, propozoi që të ftohen të gjitha shoqatat që merren me mbrojtje të pacientëve dhe edhe ndonjë përfaqësues i spitaleve nga sektori privat.

Shemsedin Dreshaj, tha se nëse e kemi fokus sigurinë e pacientëve, duhet të ftohen ata që janë aktorë dhe propozoi që të ftohen edhe drejtorët e spitaleve rajonale.

Fatmire Kollçaku, tha se do ta shqyrtojmë mundësinë, në bazë të hapësirës që e kemi në sallë, ku organizohet kjo tryezë, të ftohen edhe përfaqësues të tjerë të institucioneve që u propozuan, që kanë të bëjnë më të drejtat dhe sigurinë e pacienteve.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

E përgatiti: Staf i mbështetës i Komisionit

Fatmire Kollçaku,

Kryetare e Komisionit